

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit N.SH E. me seli në P. ... A. ., të cilin e përfaqësoi sipas autorizimit avokati I. D. nga P., ndaj të të paditurës N.N.P K.i rr.”.....” pn, P., lidhur me pagesën e borxhit në shumë të përgjithshme prej;11.000,00euro,në seancën e shqyrtimit kryesor të datës;25.11.2016, në prani të të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të të paditurit, me datën 08.12.2016 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Shfuqizohet Aktvendimi i kësaj Gjykate për lejimin e përmbarimit E.nr.681/13, i datës 26.07.2013, kështu që ky Aktvendim për borxhin kryesor, kamatën dhe shpenzimet, suprimohet në tërësi.

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.SH E. me seli në P. .. A. ..

I.Detyrohet e paditura N.N.P K. rr.”.....” pn, me seli në P., që në emër të borxhit t’ia paguaj paditëses shumën e përgjithshme prej 9,918.00 euro (nëntë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë euro), me kamatë të cilën paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 25.11.2013, e deri në pagesën definitive,të gjitha këto në afatin parativ prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II.DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensoj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej: euro, në afatin kohor prej 7 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi N.SH E. me seli në P. .. A. ., ka parashtruar pranë kësaj gjykate propozimin për përmbarimin lidhur me pagesën e borxhit kryesor në shumë prej 11,000.00 euro, në bazë të faturës, ndaj pales së paditur N.N.P K. rr. “.....” pn, P. .

Gjykata me aktvendimin E.nr. 681/13, të datës 26.07.2013, ka lejuar përmbarimin ndaj të cilit e paditura ka parashtruar kundërshtim. Mbi bazën e ushtrimit të kundërshtimit në kuptim të nenit 57.3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), Aktvendimi për përmbarim është shfuqizuar në pjesën detyrimore, që ka të bëjë me borxhin kryesor dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe çështja konform nenit 58 paragrafi 4 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr.03/1-008) ka kaluar në procedurë kontestimore, në të cilën propozimi për përmbarim ka marrë cilësinë e padisë.

Lidhur me këtë çështje juridike Gjykata duke u bazuar në nenin 423 par. 4 të LPK-së, mbajti seancën kryesore, në mungesë të të paditurit, pasi që i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt me çka u vërtetua nga fletëkthesa, e cila gjindet në shkresat e lëndës, por mungesën e tij nuk e ka arsyetuar.

Përfaqësuesi i paditësit gjatë seancës kryesore, ka theksuar se paditësi dhe i padituri kanë qenë në marrëdhënie afariste sipas kontratës së dates 01.07.2012, lidhur me ekzekutimin e

punëve respektivisht të instalimeve elektrike për aneksin e shkollës fillore “N.M.” në fshatin B., po ashtu për punën e kryer paditësi e ka faturuar faturën 1/2012, ku dhe e ka pranuar me kohë por nuk e ka përmbushur obligimin e tij, paditësi pas marrjës së ekspertizës teknike ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar pagesën e borxhit në lartësi prej 9,918.00 euro, duke kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri përmesë kundërshtimit /përgjigjes në padi të dates 16.10.2013, ka theksuar se paditësi nuk e ka përmbushur obligimin e tij sipas kontratës dhe se një pjesë të borxhit e paditura e ka paguar në kesh në vlerë prej 2000 euro, ndërsa tani i ka borxh vetëm shumën prej 6000 euro, dhe se kjo pagesë nuk është bërë për shkak se ende nuk ka arritur afati për pagesë pasi që paditësi është dashur ta përcjellë një vit funksionimin e instalimit elektrik në objekt.

Për vërtetimin e gjendjes faktike juridike gjykata i administroi këto provat dhe atë duke filluar nga: kontrata me nr.01/2012 dt.01.07.2012 , profatura nr.1/2012 e muajit korrik –gusht 2012, njoftimi i fundit për pagesë nga paditësi dt.01.07.2013, oferta , ekspertiza teknike nga eksperti Y. Z. e muajit tetor 2016.

Deklarimet e të autorizuarit të paditëses, deklaramet e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, si dhe provat e prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha,veç e veç dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 par.1 dhe 2 të LPK-së, dhe gjeti se:

Në mes palëve në procedurë nuk ishte kontestuese se kanë pasur marrëdhënje afariste sipas kontratës së dates 01.07.2012, për ekzekutimin e punëve të instalimeve në shkollën fillore “N. M.” në fshatin B..

Nga pro-faturat, gjykata vërtetoi se e paditura ka pranuar pro faturën me të cilën e ka nënshkruar dhe vulosur, po ashtu faturat përmbajnë përshkrimet lidhur me punët e kryera ashtu sipas kontratës së lartë cekur, çmimin si dhe shumën e përgjithshme sipas marrëveshjes e përshkruar në atë faturë.

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertizës teknike e muajit tetor 2016 i punuar nga eksperti Y. Z. ka vërtetur se paditësi e ka kryer punë më tepër se kontrata që ka pasur me të paditurën NNP K. me seli në P., por nuk ka kryer të gjitha punët e parapara sipas ofertës dhe marrëveshjes në kontratë, me një diferencë prej 1,216.00 euro, që paraqet 9.35% të punëve sipas ofertës, pa prejudikuar në kualitetin e materialeve dhe kualitetin e punëve, ku në mënyrë tabelare eksperti i ka kontaktuar punët e përfunduara dhe të papaguara arrin shumën prej 9,918.10 euro.

Nga provat e administruara si më sipër rezulton se paditësi dhe e paditura kanë qenë në marrëdhënie afariste për kryerjen e instalimeve respektivisht e paditura duke pranuar dhe duke mos i kontestuar faturën e pranuar, ka pranuar punët e kryera nga paditësi lidhur me instalimin elektrik andaj në kuptim të nenit 42 paragrafi 3 i LMD-së, edhe është krijuar raporti detyrimor. Nga faturat e administruara vërtetohet fakti se paditësja me porosit e marra nga e paditura ka kryer obligimet ndaj të paditurës, duke ia dërguar faturat për shërbimet e kryera, ndërsa e paditura, nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj paditëses sipas faturës së pranuar,po ashtu edhe nga mendimi dhe konstatimi i ekspertizës teknike është vërtetuar se për punët e kryera arrin shumën prej 9,918.00 euro.

Pretendimet e të paditurës në kundërshtim/përgjigje në padi se një pjesë të borxhit e ka paguar në kesh dhe atë në vlerë prej 2000 euro, gjykata e refuzoj si të pa bazuar për faktin se e paditura asnjëherë nuk ka gjetur gatishmëri që të prezantojë në seanca dhe të ofrojë prova për të vërtetuar këto pretendime, ndërsa sipas nenit 319 paragrafi 1 të LPK-së secila palë ka për detyrë që t'i provojë faktet mbi të cilat e bazon pretendimin e saj .

Po ashtu Gjykata vlerësoj edhe pretendimet tjera të të paditurit lidhur me atë se pjesa tjetër e borxhit nuk është paguar për shkak se është dashur një vit të mbikëqyret funksionimi i instalimeve gjykata një pretendim të tillë e refuzoj si të pa bazuar për shkak se në kontratën në fjalë nuk ka qenë e paraparë që paditësi është dashur një vit ta mbikëqyr funksionimin e instalimeve, dhe për më tepër e paditura për punët e kryera vetëm e ka pranuar pro faturën dhe se nuk e ka kundërshtuar në afatin ligjor.

Sipas nenit 262 të LMD-së, kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura me mospagimin e faturave i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartë cekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj borxhin në shumën e gjykuar.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga pala paditëse dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro, për ekspertizë të elektron shumën prej 200 euro, për precizim të kërkesëpadisë shumën prej 104 euro, për taksë në padi shumën prej 55 euro, për taksën për aktgjykim shumën prej 55 euro dhe për përfaqësim në dy seanca nga 135 euro, shumën prej 270 euro, gjithsej shumën e përgjithshme prej 788.00 euro.

Lidhur me vendimin me afatin paritiv gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 509 pika e të LPK-së. Andaj, gjykata pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitën e nenit 262 të LMD-së si dhe në dispozitën e nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje ekonomike
III.EK.nr.593/2013, me datë 08.12.2016

Gjyqtarja
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.